

# Priority Primary Care Centres (Qendra Prioritare të Kujdesit Parësor)

## A keni nevojë të takoni urgjentisht një mjek?



Priority Primary Care Centres (Qendrat Prioritare të Kujdesit Parësor) ofrojnë trajtim falas për të gjithë personat me dëmtime apo sëmundje urgjente.

Mjekët e qendrës PPCC do ju ndihmojnë të merrni trajtimin që ju nevojitet, më shpejt se në departamentin e urgjencës së një spitali.



Ata mund të trajtojnë gjendje të tilla si infeksione të lehta, djegie të vogla, ndrydhje ose kocka të dyshuara për thyerje. Shërbimet e PPCC përfshijnë patologjinë, radiologjinë dhe farmacinë.

Nëse keni ndonjë dëmtim apo sëmundje serioze, telefononi Triple Zero (000) (Shërbimin e Urgjencës). Nëse nuk keni nevojë për kujdes urgjent, lini një takim me mjekun tuaj të zakonshëm.



Shërbimet e PPCC janë falas për të gjithë personat, me apo pa kartën e Medicare.



Në qendrat PPCC ka përkthyes të disponueshëm. Telefononi Shërbimin Kombëtar të Përkthimit dhe të Interpretimit (në anglisht: Translating and Interpreting Service National, e quajtur ndryshe "TIS National") në numrin e telefonit 131 450.



Për vendndodhjen e qendrave dhe për më shumë informacion, vizitoni Kanalin 'Për një shëndet më të mirë' (në anglisht: Better Health Channel) në faqen: [betterhealth.vic.gov.au/priority-primary-care-centres](https://betterhealth.vic.gov.au/priority-primary-care-centres)